



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel 04 22 68 141; 22 68 142

Nr. 1344 Prot.

Tiranë, më 30.06.2017

V E N D I M

Nr. 146, datë 30.06.2017

"Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 34, datë 16.02.2017, 'Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Drejtorinë e Bujqësisë Durrës dhe paralajmërimit të institucionit për të rregulluar ligjshmërinë'".

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil mbikëqyr, kryesisht ose me kërkesë të institucioneve, zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civil, nxjerr vendime paralajmëruese në rast se konstaton parregullsi dhe përcakton detyra konkrete për rregullimin e situatës.

Për këtë arsye:

Në zbatim të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenet 11/1 dhe 14 , të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin paralajmërues Nr. 34, datë 16.02.2017, të Komisionerit.

VENDOSA:

1. Fillimin e verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 34, datë 16.02.2017, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin, e Drejtorisë së Bujqësisë Durrës dhe paralajmërimit të institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë".
2. Ngritjen e grupit të punës, me këtë përbërje:
 1. **Stela Ndoka** Specialist, Drejtorja e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë
 2. **Helga Peti** Specialist, Drejtorja e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë
3. Ky proces do të fillojë me paraqitjen e grupit të punës në subjekt, në datën **07.07.2017**.

4. Me përfundimin e verifikimit të akteve, grumbullimit të dokumentacionit dhe të dhënave në subjekt, grupi i punës, do të vijojë punën me përpunimin e të dhënave. Aktet e konstatimit, procesverbalet e mbajtura në subjekt si dhe dokumentacioni i administruar, lidhur me zbatimin e vendimit të Komisionerit do t'i paraqiten për të vijuar procesin Drejtorit të Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, brenda datës **10.07.2017**. Relacioni duhet të përpilohet deri në datën **12.07.2017**. Më pas do t'i paraqitet për miratim Komisionerit, dhe më tej, do të hartohet vendimi për përmbylljen e procesit, brenda datës **17.07.2017**.
5. Vendimi përfundimtar i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për përmbylljen e verifikimit do t'i dërgohet subjektit të mbikëqyrur, Drejtorisë së Bujqësisë Durrës, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Departamentit të Administratës Publike dhe Komisionit për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike.
6. Ngarkohet Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, që të marrë masat për realizimin e procesit, duke filluar me njoftimin e subjektit që do t'i nënshtrohet mbikëqyrjes në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative dhe të akteve që janë pjesë e këtij vendimi.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel 04 22 68 141; 22 68 142

Nr. 1344/1 Prot.

Tiranë, 30.06.2017

M I R A T O H E T

Pranvera STRAKOSHA

KOMISIONER

PROGRAM VERIFIKIMI

“Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 34, datë 16/02/2017, ‘Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Drejtorinë e Bujqësisë Durrës dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar ligjshmërinë’”.

- 1. Subjekti i mbikëqyrjes:** **Drejtoria e Bujqësisë Durrës**
- 2. Objekti i verifikimit:** Zbatimi i Vendimit paralajmërues Nr. 34, datë 16.02.2017, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Drejtorisë së Bujqësisë Durrës dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”*, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.
- 3. Baza ligjore:** Neni 14, i ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe Rregullorja *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.
- 4. Afati i verifikimit:** Verifikimi do të fillojë në institucion në datën **07.07.2017**
- 5. Procedura që do të ndiqet:** Për parregullsitë e konstatuara do të mbahen aktet e konstatimit, procesverbal administrativ, të cilët do të nënshkruhen nga grupi i verifikimit dhe personat përgjegjës, si dhe do të merret kopja e dokumentacionit përkatës, vërtetuar nga sekretaria e institucionit.

6. Grupi i punës:

1. Stela Ndoka

Specialist Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë,

2. Helga Peti

Specialist, Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë

7. Dokumentimi i rezultateve të verifikimit:

Në përfundim të procesit të verifikimit do të përgatitet relacioni përkatës nga Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, bazuar në aktet e konstatimit dhe procesverbalet e mbajtura në subjektin e verifikuar si dhe do të administrohet dokumentacioni provues. Më pas do të hartohet vendimi përfundimtar i procedurave përmbyllëse të verifikimit të zbatimit të vendimit, i cili do të dërgohet institucionit (*n.q.s vendimi nuk është zbatuar, Komisioneri do të zbatojë kompetencën e parashikuar në nenin 15, pika 2, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar*).

DREJTIMET E VERIFIKIMIT

I. Si janë zbatuar, detyrat e lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në Vendimin Nr. 34, datë 16.02.2017 *"Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin, e Drejtorisë së Bujqësisë Durrës dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë"*, nga ana e Njesisë së Burimeve Njerëzore të institucionit të mbikëqyrur. Në këtë rast, verifikimi do të realizohet duke pasur parasysh nivelin e zbatimit të urdhërimeve në vendimin paralajmërues, si më poshtë, duke administruar kopje të akteve që materializojnë zbatimin e vendimit:

2. *"Njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike si dhe njësia e burimeve njerëzore të institucionit të mbikëqyrur, duhet të marrin masa dhe të tregojnë kujdes, që procedurat që kanë lidhje me menaxhimin e shërbimit civil dhe janë kryer në mënyrë elektronike, t'i materializojnë ato edhe në formë shkresore, duke respektuar mënyrën dhe elementët që duhet të përmbaje kopja në letër e dokumentit elektronik, të përcaktuara në ligjin nr. 9880, datë 25.2.2008, "Për nënshkrimin elektronik", i ndryshuar, ligjin nr.10273, datë 29.4.2010, "Për dokumentin elektronik" si dhe në udhëzimin nr. 1, datë 31.12.2012, të Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit, "Për vërtetimin e kopjes në letër të dokumentit elektronik nga institucionet publike"*.

Me qëllim kontrollin e zbatimit të ligjit në administrimin e shërbimit civil nga nëpunësit përgjegjës, në përputhje me hierarkinë administrative, ashtu dhe nga institucionet e ngarkuara nga ligji për mbikëqyrjen e shërbimit civil, këto kopje duhet të trajtohen në përputhje me kërkesat e ligjit për arkivat dhe normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.

Në këtë këndvështrim, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, duhet të finalizojë procesin e hartimit të përshkrimeve të punës, duke u kujdesur që të merret mendimi i Departamentit të Administratës Publike dhe më tej të depozitohet ato në arkivin e institucionit, si dhe pranë Departamentit të Administratës Publike.

3. *Njësia përgjegjëse (DAP), a) në kushtet e ndryshimit që ka sjellë në regjimin juridik të marrëdhënies së punës, Vendimi nr. 877, datë 14.12.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 719, datë 31.10.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, për nëpunësit e Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, i cili, i ka përfshirë ata përsëri në shërbimin civil, si dhe, b) duke marrë parasysh, detyrimin që ka DAP, për të zbatuar nenin 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duhet t’i aplikojë këto ndryshime, sipas orientimeve në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, edhe në rastin e punonjësve ***** dhe *****; të cilët, për shkak të ristrukturimit, janë transferuar nga Drejtoria e Bujqësisë Durrës në pozicionin e punës, “Specialist”, pranë Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural.*
4. *Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 30 ditë nga marrja dijëni për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në orientimet e dhëna në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.*
5. *Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, Drejtoria e Bujqësisë Durrës, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.”*

Në rast të konstatimit të moszbatimit të pjesshëm apo të plotë të vendimit të Komisionerit, do të mbahet procesverbal konstatimi, i cili do të nënshkruhet nga grupi i punës dhe personi përgjegjës.

Aneks i programit: Aktet administrative që duhet të vihen në dispozicion të grupit të verifikimit.

- II.** Në vijim të programit të verifikimit, më poshtë po rendisim aktet që duhet të vihen në dispozicion të grupit të verifikimit për të përfunduar këtë proces.
 1. Provat shkresore të cilat vërtetojnë zbatimin e detyrave të lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me vendimin paralajmërues.
 2. Materiale të tjera të cilat do të konsiderohen të domosdoshme për verifikimin e situatës së shërbimit civil në këtë institucion, gjatë procesit të verifikimit.

**DREJTORI I ÇËSHTJEVE JURIDIKE
DHE I MARRËDHËNIEVE ME JASHTË**

Enkelejda HEBIBASI